



1. Mirë se vini në bibliotekë!
2. Biblioteka ka kënaqësinë të ju mirëpres si vizitor. Gjatë orarit të punës në bibliotekë ju mund të keni qasje të lirë në të gjithë letërsinë dhe mediat e ndryshme të saj.
3. Këto letërsi e media mund t'i gjeni në bibliotekën tonë:
Media në formë të shtypur, audio dhe video.
 - 3.1. Librat, librat audio, librat për mësimin e gjuhëve të huaja, hartat, DVD-të me përmbajtje faktike si dhe DVD-të dhe CD-ROM-ët me përmbajtje muzikore mund të huazohen për 4 javë.
 - 3.2. Ndërsa CD-të muzikore, filmat, lojërat në konsol dhe revistat mund të huazohen për 2 javë.
4. Kushtet e huazimit
 - Pagesa tarifore për huazimin e letërsisë dhe mediave për një vit është 18 €.
 - Fëmijët nën moshën 19-vjeçare dhe poseduesit e "kartelës Ludwigsburg" nuk paguajnë ndonjë tarifë vjetore për huazim. Refugjatët, të cilët ende nuk posedojnë një "kartelë Ludwigsburg", lutën të sjellin me vete formularin e regjistrimit të tyre të vendbanimit.
 - Shumica e letërsisë dhe mediave tona mund të huazohen pa pagesë.
 - Për huazimin e çdo filmi për të rritur dhe loje Nintendo DS duhet të paguani nga 1 € .
 - Për huazimin e të gjitha lojërave tjera në konsol si dhe për shërbimin e veçantë të mediave duhet të paguani nga 2 €.
 - 4.1. Ju mund të merrni me vete në shtëpi deri në 5 media të huazuara në të njëjtën kohë.
 - 4.2. Për të rezervuar njërin nga mediat tona, duhet të paguani një tarifë prej 1€. Pastaj, ju do të njoftoheni se kur mund të vini për të marrë median e rezervuar.
 - 4.3. Për regjistrimin e juaj na nevojitet një ID kartelë e vlefshme e juaja.
 - 4.4. Nënshkrimi i njërit prind është i nevojshëm për regjistrimin e fëmijëve nën moshën 19-vjeçare.
 - 4.5. Ju lutem përdorni me kujdes mediat e huazuara. Për humbjen apo dëmtimin e ndonjërit libër apo media, biblioteka është e detyruar të kërkojë dhe të mbledhë tarifën përkatëse për humbje apo dëmtim.
 - 4.6. Me rastin e huazimit të letërsisë dhe mediave të ndryshme, në ekranet e huazimit automatik ju lutem klikoni "shtyp dhe përfundo" (Drucken und Beenden), për të marrë një letër në të cilën është e shënuar koha e lejuar (afati) e huazimit të një medie.
5. Kthimi
 - 5.1. Ju mund të mbani letërsinë dhe mediat deri në datën e shënuar si dita e fundit në letrën e juaj.
 - 5.2. Ju lutemi ktheni me kohë letërsinë dhe mediat apo shtyjeni kohën e huazimit të tyre. Biblioteka është e detyruar të kërkojë dhe të mbledhë një tarifë përkatëse për letërsinë dhe mediat e vonuara.
6. Përdorimi i internetit

Ju mund të përdorni internetin pa pagesë për 5 orë në javë nëpër vendet tona të punës në bibliotekë me një kartelë të vlefshme të bibliotekës.

Ju mund të përdorni WLAN tonë të lirë (WLAN - LB).
7. Të tjera
 - Ju mund të përdorni "Press Reader" në bibliotekën tonë, në sallën e revistave, për të lexuar lajme të ndryshme nga e gjithë bota në të gjitha gjuhët.
 - Ju mund të mësoni "gjuhën gjermane si gjuhë të huaj" (DaF) në shtëpi ose në bibliotekën tonë përmes mediave të ndryshme (tableta, libra, etj.).
8. Ju faleminderit për vizitën!